



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.07, datë 01.08.2023

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“RIKONSTRUKSION DHE SHITESË KATI NË GODINËN E FAKULTETIT TË
SHKENCAVE SOCIALE”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË TIRANË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues Universiteti i Tiranës, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Rikonstruksion dhe shtesë kati në godinën e Fakultetit të Shkencave Sociale”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me zhvillues Universiteti i Tiranës .
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
OCERTA MANASTIRLIU



SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAIDA ROKA



Nënshkuar më datë 24 / 12 /2023